



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS
FAKULTETI I BIZNESIT
DEPARTAMENTI I MARKETINGUT

Nr. 227/3 prot

Durrës, më 12. 05. 2026

**VENDIM DEPARTAMENTI
NR. 7, DATE 12. 05. 2026**

Bazuar në Ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", dhe rregulloret e UAMD për programin e Ciklit të tretë të studimit "Doktoraturë në Shkenca Ekonomike", ne bazë të Vendimit të Departamentit të Marketingut nr. 27 datë 18.01.2024 "Mbi kriteret e pranimit të studentëve për ciklin e parë Bachelor, në ciklin e dytë të studimeve Master Shkencor, dhe ciklin e tretë të studimeve Doktoratë, për Departamentin e Marketingut për vitin akademik 2025-2026., vendosi të përshtatë këto kritere sipas formatit të ri të kërkuar, pa ndryshuar asnjë prej kriterëve, si vijon:

I. Kriteret e pranimit për kandidatet e doktorates.

- 1) Aplikanti për programin e studimit të Doktoratës në Shkenca Ekonomike", duhet të ketë përfunduar studimet Bachelor dhe Master i Shkencave në Shkenca Ekonomike, Menaxhim Marketing ose të përafërta me to.
- 2) Aplikanti duhet të ketë përfunduar të dyja ciklet e studimit së bashku, (ose diplomë e integruar e nivelit të dytë, DIND), me notë mesatare të ponderuar 8 e lart.
- 3) Në rastet kur aplikanti ka përfunduar studimet në një universitet të huaj diploma duhet të jetë e njohur dhe e konvertuar nga Ministria përkatëse për Arsimin.
- 4) Aplikanti duhet të ketë njohuri të thelluara teorike në profilin përkatës të shkencave ekonomike, menaxhim marketingut ose në fusha të përafërta.
- 5) Kandidati duhet të njohë një prej pesë gjuhëve të huaja të Bashkimit Europian: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht, e vërtetuar përmes testeve të njohura ndërkombëtarisht në përputhje me udhëzimin përkatës të Ministrisë përgjegjëse për arsimin (Udhëzimit Nr. 52, datë 03.12.2015, e ndryshuar). Nëse kandidati ka fituar një diplomë të një programi studimi të kryer në një nga këto gjuhë, diploma e fituar shërben si dëshmi për plotësimin e këtij kriteri.
- 6) Kandidatët konkurojnë me propozim për projekt individual kërkimor shkencor, të dakortësuar me Udhëheqësin Shkencor.
- 7) Kandidati dëshmon përkushtim dhe motivim të mjaftueshëm në realizimin e punës kërkimore shkencore të Doktoratës në Shkenca Ekonomike, të dëshmuar përmes planit kërkimor që dorëzon në dosjen e aplikimit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS
FAKULTETI I BIZNESIT
DEKANI

- 8) Kandidati rekomandohet për të realizuar programin e Doktoratës të paktën nga 2 profesorë të cilët njohin eksperiencën akademike dhe kërkimore shkencore të kandidatit.
- 9) Kandidati duhet të ketë punë hulumtuese kërkimore shkencore në një nga fushat e Shkencave Ekonomike, Menaxhim Marketingut ose të përafërta me to.
- 10) Kandidati duhet të ketë eksperiencë jo më pak se 2 vite në mësimdhënie apo në kërkim shkencor në një institucion të Arsimit të Lartë, apo institucione të kërkimit bazë apo të zbatuar.
- 11) Përfshihen nga ky kriter studentët e ekselencës.

II. Metodologjia e vlerësimit (Pikezimi)

Tabela e pikëzimit për vlerësimin e dosjeve në Departamentin e Shkencave Ekonomike

Mesatare Bachelor	Fusha	Staf Akademik me kohe te plote FT-UAMD	Eksperienca ne mesimdhënie	Publikime Shkencore	PROJEKT I	TOTAL I
(max 100 pike, duke filluar nga 20 pike nota 8 (tete), per cdo 0.1, shtohet 4 pike)	100 pikë, Shkenca Ekonomike 50 pikë, Shkenca të përafërta – 20 pikë)	100 pikë, Universitetet të tjera publike dhe jopublike - 50 pikë, Punonjës të institucioneve kërkimore shkencore – 20 pikë	Max 10 duke filluar nga 40 pike për 2 vite eksperiencë dhe 20 pikë për cdo vit shtese – max 5 vite vlerësim.	(Max 100 pike. 10 pike per cdo Aktivitet (5 x 10) dhe 10 pike për cdo botim (5x10)	(MAX 100 Pike, vlerësim	(Max 600 pikë)

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

Drejtuesi i Njësisë Bazë
Prof. As. Dr. Vaela Zhezha